

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga Shqipe Qerimi, Kryetare, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkpunëtorit profesional Hysni Ismaili procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve I.F. nga K.e Skenderaj për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, dhe P.F. po ashtu me vendbanim të njëjte për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën para 1.1 të KPRK-së duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuar av.G.R., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, P.nr.116/2016 të datës 24.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe e mbrojtësit të akuzuar I.F., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, P.nr.116/2016, i datës 24.10.2016, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, me aktgjykimin P.nr.116/2016 të datës 24.10.2016, të akuzuarin I.F., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë prej 700 (shtatëqind) euro, dhe P.F. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 nën para 1.1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë prej 700 (shtatëqind) euro. Të akuzuarve I.F. dhe P.F. kohën e kaluar në paraburgim prej 03.05.2016 deri me 01.06.2016, iu llogaritet me dënimin e shqiptimit me gjobë.

Të akuzuarit dënimin e shqiptuar me gjobë janë të obliguar që ta paguajnë në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën gjykata dënimin me gjobë do t'ua zëvendësoj në dënim me burgim sipas dispozitës ligjore nga neni 46 par.3 të KPRK-së.

Të akuzuarit i ka obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë secili prej tyre shumën prej 30 euro, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë obligohen t'i paguajnë secili prej tyre shumën prej 10 euro, të cilat janë të obliguar që t'i

paguajnë në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Palën e dëmtuar e ka udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Ndaj të akuzuarit I.F. krahas dënimit kryesorë, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 69 par.1.të KPRK-së i shqipton edhe dënimin plotësues marrja e një tërfurku me gjatësi prej 160 cm, si mjet i cili është përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe e ligjshme, kurse aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarve të ju shqiptohet dënimi me burg efektiv.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.F. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje, dhe ndaj të akuzuarit të shqiptoj një dënim të kushtëzuar.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/II.nr.4/2017 të datës 10.01.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të aprovohet si e bazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuar I.F. të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1.nen para.1.12 të KPRK-së, sepse aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 par.7 të KPRK-së, aktgjykimi i ankimuar është bazuar në provë të papranueshme-në deklaratat e të dëmtuarit H.Sh., të dhëna në polici dhe prokurori, e të cilat deklarata fare nuk janë lexuar në shqyrtimin kryesorë, po ashtu gjykata aktgjykimin e ankimuar e bazon edhe në dëshminë e dëshmitares Sh.F., të cilës dëshmi në pjesët e caktuara ia fali besimin nga se e njëjta bazohet edhe në deklaratimet e të dëmtuarit dhe provat tjera materiale, mirëpo nuk jep arsye se cilat janë ato pjesë të deklaratës së kësaj dëshmitareje që ju ka falë besimin e plotë, e cila janë ato pjesë të deklaratës që nuk ia ka kushtuar besimin e plotë.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale

të pretenduara e as që ka shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë, nuk përmban kundërthënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, i vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merre si të provuara ose si të paprovuara dhe njëkohësisht ka bërë vlerësimin e provave kontradiktore.

Përkitazi me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike sipas pretendimeve në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit theksohet se gjykata përveç deklaratës së të dëmtuarit me asnjë provë tjetër nuk është vërtetuar se i akuzuari I.F. e ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar edhe gjendjen faktike ku gjatë shqyrtimit gjyqësorë i administroi-dëgjoi dëshmitaren Sh.F. dhe bëri administrimin e provave të tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç ishin shkresat policore me nr.2016-BF-0186 të dt.03.05.2016, raporti i oficerit i dt.03.05.2016, raportet mjekësore në emër të të dëmtuarit, ekspertiza mjeko ligjore në emër të të dëmtuarit H.Sh. i dt.11.05.2016, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt.03.05.2016, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i dt.03.05.2016 si dhe bëri vështrimin në foto dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Gjendjen faktike si në pikën 1 (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi sa i përket të akuzuarit I.F., gjykata e vërtetoi nga deklarimi i të akuzuarit të dhënë në policinë e Kosovës dhe në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, ku në këto dy deklarata ka deklaruar se ditën kritike ai kishte qenë në shtëpinë e tij e cila gjendet në K.e Skenderaj. Po ashtu gjendjen faktike si në pikën 1 (një) të dispozitivit të aktgjykimit gjykata e vërteton pjesërisht edhe nga dëshmia e dëshmitares Sh.F. të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me datën 30.09.2016, me të cilat dëshmi në mënyrë të plotë dhe të drejtë u vërtetua gjendja faktike.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuar pretendohet se gjykata ka bërë shkelje në dëme të të akuzuarit kur të njëjtin e ka shpallur fajtorë dhe e gjykon me dënim me gjobë, sipas mbrojtjes në ankesë, dënimi i shqiptuar është shumë i ashpër dhe gjatë shqiptimit të dënimit gjykata nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese të cilat parashihen me ligj gjatë shqiptimit të dënimit.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale kur ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit I.F. ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, ngase i njëjti ndaj të dëmtuarit me dashje e ka përdorur forcën, për çka gjykata të akuzuarin e shpallë fajtorë dhe penalisht përgjegjës për veprën me të cilën ngarkohet.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal, në ankesën e prokurorit theksohet se gjykata me rastin e caktimit të dënimit ndaj të

akuzuarit pati parasysh vetëm rrethanat lehtësuese, ndërsa rrethanat rënduese nuk i ka marrë fare për bazë e as nuk i ka vlerësuar, po ashtu gjykata nuk mori për bazë edhe faktin se i dëmtuari nuk arriti kurrfarë marrëveshje të pajtimit me të pandehurin, ku edhe më tutje raportet e tyre nuk qëndrojnë të mira edhe pse të njëjtit jetojnë në një fshat, ndërsa në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit nuk arsyetohet vendimi mbi dënimin me arsyetimin se dënimi është jo i drejtë, megjithatë Gjykata e Apelit e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese si : sjelljen korrekte para gjykatës, ndërsa rrethanë rënduese gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit pretendimet e prokurorit për shqiptimin e një dënimi më të ashpër dhe të mbrojtësit për një dënim më të butë janë të pabazuara, ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe rënduese nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në matjen dhe caktimit e dënimit, e i duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, edhe kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, ku do të parandalohet kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, te parandalohet personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1605/16, me dt. 06.03.2017.

Procesmbajtësi
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
Shqipe Qerimi

Anëtarët e kolegjit:

1. Rasim Rasimi

2. Gani Zabeli